



RREGULLORE PËR CAKTIMIN E STANDARDEVE OPTIMALE PËR KUSHTET HIGJIENO SANITARE

Dhjetor 2018

Me këtë rregullore përcaktohen standardet optimale për krijimin e kushteve të domosdoshme higjienik-sanitare, në objektin e HANDIKOS-IT, si dhe përcaktohen kushtet për individët stafin dhe anëtarëve gjatë qëndrimit ditore. Për qëllim të kësaj rregullore shprehjet kanë këtë domethënie:

Higjiena – disiplinë e mbrojtjes shëndetësore që ka për detyrë të mbroj shëndetin e individëve.

Sanitari- disiplinë mjekësore që merret më ndikimin e faktorëve të mjedisit jetësor në shëndetin e njerëzve, në të njëjtën kohë gjetjen e mënyrave të eliminimit të faktorëve negativ

Anëtarë - personi i cili përfiton nga shërbimet ne HANDIKOS, dhe është i regjistruar ne regjistrin e librezave.

1. MJETET HIGJIENIKE

1. Hapësira në të cilat është i vendosur i anëtari gjate qëndrimit ditore duhet të jenë të pastërta, të pastrohen çdo ditë, me produkte cilësore të cilat nuk shkaktoje efekte anësore, siç janë alergjitë ose me përbërës të tjerë të cilët nuk përdoren në vendet e mbyllura.

2. Hapësirat të jene të murosurat duhet të gëlqerosën të pakën një herë në vit dhe sipas nevojës edhe dezinfektohen. Mjetet higjienike për pastrimin e lokaleve sigurohen nga HK.

3. Me rastin e përcaktimit të mjeteve higjienike personale për anëtarët duhet të merren për bazë por pa u kufizuar rrethanat si në vijim: mosha, gjinia, gjendje shëndetësore, statusi, rekomandimet e mjekut etj

Përpos pajisjeve higjienike të përcaktuara më larte anëtarëve në rast nevojë duhet të i sigurohen edhe pajisjet higjienike si në vijim:

- A. shampon dhe pampersa.
- B. vata higjienike mujore për femra.
- C. pampersa për të rritur.
- D. mjete për inkontinence



B.M.

2. GJËRAT ELEMENTARE PËR USHQIM, FJETJE DHE QËNDRIM DITOR

Anëtarit të i sigurohet shtrati gjatë qëndrimit ditore që përbehet prej krevatit ose shtratit të posaçëm dhe duhet siguar:

- 1.1. një (1) dyshek;
 - 1.2. dy (2) çarçafë;
 - 1.3. dy (2) batanije;
 - 1.4. një (1) jastëk;
 - 1.5. një (1) këllëf jastëku;
 - 1.6. dy (2) peshqirë dhe atë një i vogël dhe një i madh;
 - 1.7. luge, pirunë, thike, për ushqim jo të mprehura, ose të plastikes
 - 1.8. lodrat për fëmijë të certifikuar me cilësi, dhe të cilat nuk paraqesin rrezik.
 - 1.9. si dhe evitimi i të gjitha objekteve të cilat në mënyrë të tërthortë mund të paraqesin rrezik
- Sendet e mbulojës rregullisht pastrohen dhe ajrosen e ndërrohen të paktën një herë në shtatë (7) dite dhe sipas nevojë edhe dezinfektohen.

3. AMBIENTI I BRENDHEM

1. Ambienti i brendshme përfshirë kuzhinën banjën, wc-te, në çdo kohë duhet të jenë në nivel të lartë higjienik, të paktën 1 herë në javë duhet të bëhet edhe dezinfektimi i përgjithshëm.
2. Dezinfektimi dhe përdorimi i kemikateve të ndryshme nuk guxon të bëhet gjatë ditës kurë anëtarët janë në qëndrim ditore ose stafi është në punë.



B.M.

*Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 dhe 3 të statutit të organizatës HANDIKOS,
Kuvendi i Anëtareve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17.07.2019
Aprovon dokumentin e titulluar, Rregullore për Caktimin e Standardeve Optimale për Kushtet Higjiene
Sanitare, rregullorja përbehet nga tre faqe me gjithsej 3 pika*

Kryesues i Kuvendit të Anëtareve, Bujar Morina



B.M.